




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo




Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture Forestry and Rural Development

DATË/A:	21.06.2024
PËR/ZA/TO	Ofertë Publike
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Zyrën e Kryetarit z. Fadil Nura
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Behxhet Maliqi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dhënia me qira e vendgjuetisë “Drenica” në Skenderaj.



PËR DHËNIE ME QIRA TË VENDGJUETISË “DRENICA” SKENDERAJ

Të dhënat kryesore

Me qëllim të rregullimit dhe menaxhimit me kafshë të egra në territorin e Komunës së Skenderajt, përgatitjen cilësore të procedurave për dhënie me qira të Vendgjuetive të Përbashkëta dhe seleksionimin cilësor të kompanive të interesuara, që konkurrojnë në menaxhimin e vendgjuetive, në përputhje me aktet ligjore: Ligji për Gjueti nr.02/L-53, Udhëzimi Administrativ për Dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta nr.06/2009 si dhe akte dhe nën-akte tjera ligjore të ndërlidhura me menaxhimin e kafshëve të egra dhe gjuetinë. Kërkohet nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të bëjë zhvillimin e procedurave të ofertës-shpalljes publike për dhënie në menaxhim të vendgjuetisë së përbashkët që shtrihet në territorin e Komunës Skenderaj.

Sipërfaqja e përgjithshme e vendgjuetisë në territorin e Komunës së Skenderaj është 37.438.00 ha, ndërsa sipërfaqja aktive për ushtrimin e veprimtarisë të gjuetisë është 29.772.21 ha.

Me vendimin 01-324/01-0053534/22, të dt.27.10.2022, Kuvendi Komunal i Skenderaj ka marr vendim për themelimin e Vendgjuetisë së Përbashkët “Drenica” në Komunën e Skenderaj, dhe atë si vijon:

1. Vendgjuetia “Drenica” Skenderaj, në sipërfaqe të përgjithshme prej 37.438.50.00 ha, ndërsa sipërfaqja aktive ku mund të kryhen aktivitete gjuetie janë 29.772.21 ha.

Vendgjuetitë me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe gjuetisë janë në harmoni me kriteret e Ligjit për Gjuetinë dhe Udhëzimeve Administrative të këtij ligji dhe ligjeve tjera relevante.

Për themelimin e vendgjuetisë, ekziston Pëlqimi për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në Komunën e Skënderaj, nr.3515/02 date 10.10.2022, lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me emërtime dhe sipërfaqe përkatëse të përshkruara si më lartë.

Korniza ligjore:

Baza ligjore e themelimit të Vendgjuetive (Vendgjahishteve) të Përbashkëta është Ligji për Gjueti Nr.02/L-53, Neni 19, paragrafët: 19:1,19:2,19:3,19:4.

1. Kushtet e dhënies me koncesion apo me qira

Ligji për Gjueti ka paraparë dhënien e vendgjuetive në menaxhim nëpërmjet koncesionit dhe qiradhënies, pas themelimit të tyre. Vendimin për dhënien e vendgjuetisë/ve në koncesion e merr Ministria (MBPZHR), kurse dhënia me qira është në kompetencën e komunës/ve dhe zhvillohet nëpërmjet Ofertës Publike.

1.1 Dhënia e Vendgjuetisë së Përbashkëta me Qira

1.1.1 Përmbajtja e materialit ofertues

Me qëllim të lehtësimit të punës dhe zhvillimit të procedurave në vazhdim të këtij teksti janë numëruar të dhënat e përmbajtjes së materialit ofertues (ofertës publike) të cilat janë përshkruar në Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009 për Dhënien në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta.

Neni 4

- Përshkrimi për rëndësinë e vendgjuetisë së përbashkët, qëllimi i saj dhe vizioni i menaxhimit në të ardhmen;
- Emërtimi i vendgjuetisë;
- Harta, sipërfaqja dhe përshkrimi i kufijve të vendgjuetisë;
- Struktura e sipërfaqes (pyje, toka pyjore, livadhe, kullosa, arra, kopshte etj.);
- Llojet dhe numri i kafshëve të egra në vendgjueti;
- Llojet e kafshëve të egra tradicionale për gjueti, kafshët e rralla dhe të rrezikuara dhe llojet përherë të mbrojtura;
- Infrastruktura (objektet) teknike dhe përcjellëse në vendgjueti dhe
- Çmimi fillestar.

Neni 5

Kushtet e Përcaktimit për Ofertues

Kushtet kryesore, që duhet të plotësohen për marrjen me qira të vendgjuetive të përbashkëta janë:

- Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë (konfirmimi);
- Dëshmia mbi përvojën e punës të menaxhimit me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxherët e gjertanishëm të vendgjuetive dhe kafshëve të egra, shoqatat e gjuetisë nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës, si dhe përshkrimi i rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake);
- Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme-për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm dhe ekologji;
- Dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve-gjuetarë të kualifikuar, roje të gjuetisë të kualifikuar, profesionistë të florës dhe faunës;
- Ofrimin e programit për synimin e menaxhimit dhe zhvillimit të vendgjuetive, mbrojtja dhe ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;
- Dëshmi nga gjykata ose personi përgjegjës se nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale;
- Dëshmi që vërtetohet se subjekti ofertues nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
- Dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
- Çmimi më i lartë ofertues për qiranë.

Neni 6

Komuna përkatëse obligohet që dokumentacionin e të gjithë ofertuesve dhe përfituesve të menaxhimit të vendgjuetive të përbashkëta, të i'a dërgojë MBPZHR-së - Departamentit të Pylltarisë për dhënie të pëlqimit. MBPZHR në afat kohor prej 30 ditësh e bënë shqyrtimin e dokumentacionit ofertues dhe vendos për dhënien apo refuzimin e pëlqimit.

Sugjerohet që afati i dhënies me qira të jetë 10 vite, ashtu siç është rregulluar me Nenin 2, Pika 1 e Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009.

2. Caktimi i çmimit fillestar të qiradhënies

Çmimi fillestar i qirasë (qiradhënia) është rregulluar më Nenin 35 të Ligjit për Gjueti Nr.02/L-53.

Paragrafi 35.1: Çmimi fillestar për qiranë e vendgjuetisë përcaktohet në lartësi prej 30% të vlerës së kafshëve të egra të gjuajtura në vitin e pestë të planit të menaxhimit të llogaritura sipas çmimit të tregut.

Meqenëse në Komunën e Skenderaj , nuk është dhënë deri më tani vendgjuetia në menaxhim me qira, nuk posedon Planin Menaxhues të Vendgjuetive (plani dhjetëvjeçar) rrjedh se Çmimi Fillestar duhet të caktohet sipas paragrafit 35.2 të Ligjit për Gjueti Nr.02/L-53, në të cilin shkruhet:

Paragrafi 35.2 “Në rastet kur nuk ekziston plani i menaxhimit, çmimi fillestar për qiranë e vendgjuetisë përcaktohet në lartësi prej 50% të gjuetisë vjetore të kafshëve të egra të planifikuara sipas numrit të mundshëm të egërsirave sipas aktit të themelimit të vendgjuetisë të llogaritura sipas çmimit të tregut, respektivisht sipas çmimit të përcaktuar me Udhëzim Administrativ Nr.06/2009 për Dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta”.

3. Planifikimi vjetor dhe afatgjatë i numrit të kafshëve të egra që do të gjuhen

Një prej elementeve bazë të sigurimit të menaxhimit të qëndrueshëm të faunës së egër është sigurimi i vazhdimësisë në cilësi dhe sasi (numri) i tyre. Planifikimi vjetor dhe afatgjatë i menaxhimit të kafshëve dhe shpendëve të egra, përfshirë edhe gjuajtjen e tyre, hartohet në bazë të të dhënave të inventarit (regjistrimit) të kafshëve të egra sipas llojit, moshës, gjinisë, gjendjes shëndetësore, shtrirjes e të dhënave tjera relevante. Në mungesë të inventarizimit (regjistrimit të kafshëve dhe shpendëve të egra në Republikën e Kosovës, përfshirë territorin e Komunës së Skenderajt, me qëllim të përgatitjes së zhvillimit të procedurës së Ofertës Publike), jemi shërbyer me numrin e kafshëve dhe shpendëve të egra dhe strukturën e sipërfaqeve sipas kulturave të Vendgjuetisë të Përbashkët, më rastin e themelimit.

- Të dhënat janë zyrtare por besueshmëria në saktësinë e tyre duhet të merret me rezervë.

Të dhënat tjera janë llogaritur në bazë të literaturës profesionale, njohjes dhe përvojës profesionale të kësaj lëmie si dhe njohjes të kushteve klimatike, mbulesës bimore, mundësisë së sigurimit të ushqimit, orografia, kushtet biologjike, qetësia, infrastruktura pyjore, burimet ujore, gjeomorfologjia e kushteve tjera.

Në vazhdim të këtij teksti janë paraqitur tabelat me llogaritjet dhe elementet e mjaftueshme për publikimin e Ofertës Publike për dhënie në menaxhim me qira të Vendgjuetisë së Përbashkët:

- **Ne vendgjueti nuk ka objekte teknike dhe përcjellëse të cilat do të merren në menaxhim.**

LLOJET E KAFSHËVE TË EGRA QË GJENDEN NË VENDGJUETINË “DRENICA” NË SKENDERAJ

Treguesi i kafshëve të egra sipas emrit dhe numrit është bazuar sipas Komisionit Komunal të formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës Skenderaj, në bashkëpunim me Shoqatat e Gjahtarëve.

Komisioni ka realizuar numërimin e kafshëve të egra për vendgjuetinë me ç’rast ka përfshirë të dhëna për llojin, numrin dhe raportin gjinor të kafshëve të egra të cilat të dhëna paraqiten si më poshtë:

23.	Laraska			0
24.	Huti sp			0
25	Pula e egër e madhe			0
26	Maca e egër			0
27	Çakall			0
28	Qelbsa			0

Tabela nr.2 Kafshet të cilat lejohen për gjueti dhe kalkulimi i cmimit sipas UA ne fuqi.

Nr	Lloji i kafshës së egër	Numri i vrasjeve të mundshme 1-9	Çmimi për copë/sqepa €	Shuma €	Shuma 50% nga shuma €
1	Lepur i egër	120	25	3.000.00	1.500.00
2	Derr i egër	50	450	22.500.00	11.250.00
3	Thëllëzë fushore	78	15	1.170.00	585.00
4	Patë e egër	26	15	390.00	195.00
5	Pëllumb i egër	100	10	1.000	500.00
Total				28.060.00	14.030.00
Kafshët e egra të rralla dhe të rrezikuara të mbrojtura dhe strikt te mbrojtura					
10	Kaproll	0			
11	Dhi e egër	0			
12	Ariu	0			
13	Ujku	0			
14	Sqarhi	0			
15	Mace e egër- Rrëqebulli i Ballkanit	0			
16	Ketri	0			
17	Gjeraqinë	0			
18	Bukla e vogël	0			
19	Gjeli i Rëndomtë	0			
20	Orla	0			
21	Korbat e zi	0			
22	Fazani	0			

23	Laraska	0			
24	Huti	0			
25	Pula e egër	0			
26	Çakalli	0			
27	Qelbësi	0			
Gjithsej					
Gjithsej: Çmimi fillestar vjetor për ofertën publike					= 1,403.00 €

Specifikimi i të dhënave dhe llogaritjeve për zhvillimin e procedurës së Ofertës Publike është paraqitur në tabelën nr. 2. Llogaritjet janë bërë sipas numrit të kafshëve të egra regjistruar nga Komisioni i caktuar nga kryetari, në bashkëpunim me shoqatën e gjahtarëve, me rastin e themelimit të vendgjuetisë.

Specifikimi i çmimit fillestar për kafshë të egra për të cilat biologjikisht është e mundur vrasja/gjuajtja, për Ofertën Publike për Vendgjuetinë “ Drenica ” Skenderaj

Çmimi fillestar bazë për shpallje të Ofertës Publike për Vendgjuetinë “ Drenica ” Skenderaj, sipas Ligjit për Gjuetinë është 1,403.00 € në vit.

Kushtet shtesë për përzgjedhjen e subjekteve ofertuese për marrje me qira në menaxhim të vendgjuetisë

Meqenëse qëllimi kryesor i dhënies në menaxhim të vendgjuetive është mbrojtja, kultivimi dhe shtimi i numrit të llojeve të faunës së egër si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës dhe zhvillimit të tyre, çmimi i dhënies me qira nuk ishte preferuar të jetë përcaktues kryesor i përzgjedhjes së subjektit përfitues (menaxherit të vendgjuetisë), posaçërisht në rastin e Kosovës. Sugjerimi konsiston në faktin se numri i të gjitha llojeve të faunës së egër është nën minimum optimal si dhe shumica e llojeve është edhe nën minimumin biologjik të tyre.


- Vendgjetia "Drenica" përbëhet nga kjo sipërfaqe:

Tabela nr.3 Struktur a e sipërfaqeve te vendgjetisë

PASQYRA E SIPERFAQEVE SKENDERAJ aneksi 1						
SIPERFAQJA E VENDGJETIS E	STRUKTURA SIPERFAQES E	KULTURA	PRONESIA	Ha		
1	2	3	4	5		
URRAT BRENDA VEND- GJETISE	TOKA BUJQESORE	PYJORE	TOKA PYJORE	Publike	2010.92	
				Private	12674.08	
				Σ	14685	
			PYJE	Publike	2010.92	
				Private	12674.08	
				Σ	14685	
		TOKA BUJQESORE	ARA	ARA	Publike	1235.10
					Private	16679.9
					Σ	17915
				LIVADHE	Publike	200
					Private	1419.53
					Σ	1619.53
	KULLOSA		Publike	545.26		
			Private	2673.74		
			Σ	3219		
	KULTURA SHUMËVJEQARE (PA RRETHOJA)		Publike	0		
			Private	0		
			Σ	0		
	TJERA	Publike	0			
		Private	0			
		Σ	0			
	GJITHSEJ TOKA BUJQESORE	Publike	1980.36			
		Private	20773.17			
	URRAT BRENDA VEND- GJETISE	RRJEDHESE	NATYRALE	Lumenjë	0	
Përranjë				0		

	ARTIFICIALE	Σ	0
JO RRJEDHESE	NATYRORE	LIQEJE	0
		MOQALE DHE KENETA	0
		TJERA	0
			0
	ARTIFICIALE	AKUMULIME	0
		RETENZIVE	0
		TE TJERA	0
		Σ	0
		Σ	0
	SIPERFAQJA E PERGJITHSHME E GJUESTISE SIPAS PRONESIS		PUBLIKE
		PRIVATE	33447.25
Sipërfaqja e përgjithshme e vend gjuetisë			37438.5
Sipërfaqja ne te cilat nuk lejohet gjuetia e qe janë brenda kufijve te vend gjuetisë	TOKA NDERTIMORE ZONA(URBANE)		5500.5
	SIPERFAQJA BUFERIKE 300M NGA ZONA URBANE		360.12
	SIPERFAQJA PUBLIKE(RRUGE ETJ).		1520.5
	OBJEKTET NATYRORE NEN MBROJTJE TE VECANT		285.17
			0
	OBJEKTET TE PESHKATARISE		0
	TE TJERA		0
	ZONA E NDALUAR		7666.29
SIPERFAQJA E PERGJITHSHME BREND KUFIJVE TE VENDGJUETISE			29772.21

- Ne hartën e mëposhtme është paraqitur zonat ne të cilat lejohet zhvillimi i gjuetisë dhe zonat ne të cilat është e ndaluar gjuetia ne territorin e vendgjuetise "Drenica" ne Skenderaj.



Sipërfaqja Pyjore

Sipërfaqja Bujqësore

KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Subjekti ofertues i cili plotëson kushtet ne bazë UA Nr.06/2009 do të vlerësohet nga komisioni vlerësues shpallet fitues.

Afati i shpalljes publike nga 21.06.2024 deri 08.07.2024 në ora 14.00.

Materiali ofertues sipas UA nr. 06/2009 mund te tërhiqet nga data 21.06.- 08.07.2024 ne ora 12:00 ne zyrën e Drejtorisë se Bujqësisë kati 1 , Komuna Skenderaj.

Afati për dorëzimin e ofertave pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike. Ofertat dorëzohen ne zarf të mbyllur dhe hapja e tyre do te behet ne prani te komisionit dhe të aplikueseve.

Hapja e ofertave bëhet më datën 08.07.2024 në ora 14.00, Salla e Bordit te Drejtoreve, kati 4 Komuna Skenderaj.

INFORMATË

Dhënia me qira në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta do të jepet në afat kohor prej 10 vitesh.

TË DHËNAT E APLIKUESIT PËR MARRJE NË MENAXHIM ME QIRA TË VENDGJUETISË

Emri zyrtar i subjektit:		
Numri i regjistrimit:		
Numri fiskal:		
Adresa:		
Vendi:	Kodi postar:	Komuna:
		Telefoni:
		Mob:
		Email:

Vlerësimi i ofertave: Vlerësimi bëhet nga komisioni vlerësues. Ofertuesit do të informohen me kohë në bazë të afateve ligjore të përcaktuara me akte ligjore në fuqi.

INFORMATË SHITESË PËR APLIKUESIN

Çmimi fillestar i qirasë për vendgjuetitë është: 14.030.00€ /për 10 vite

1. Vendgjuetia e përbashkët " Drenica "

Çmimi fillestar për Ofertën Publike është në lartësi prej 1.403.00€ / vit. i cili çmim është bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009. për Dhënie në Menaxhim të Vendgjuetisë së Përbashkët "DRENICA" Skenderaj. sipas të cilit Udhëzim, çmimi fillestar i qiradhënies përcaktohet në vlerë prej 50%. të kafshëve të egra të planifikuara për gjuajtje.

Llogaritjet e numrit të llojeve të kafshëve të egra janë sipas standardeve profesionale.

1. ÇMIMI I QIRASË SË OFRUAR PËR VENDGJUETINË " DRENICA" NGA APLIKUESI

_____ €.